



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA V-të

Sesioni pranveror

Komisioni për Integritet Evropian

Mbledhja nr. 13.

Prishtinë, më 17.03.2015 në ora 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, sala N-10

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR INTEGRITET EVROPIAN

Në mbledhje morën pjesë: Teuta Sahatqiu, Valdete Bajrami, Xhavit Haliti, Vjosa Osmani, Arben Gashi, Luljeta Veselaj- Gutaj, Rustem Mustafa, Ilir Deda, Time Kadriaj dhe Kujtim Paçaku.

Mungoj: Slllobodan Petroviç.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Ahtere Loxha, Safet Beqiri, dhe Florent Mehmeti.

Mbledhjen e kryesoi znj. Teuta Sahatqia – kryetare e Komisionit.

Rendi i Ditës

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i Procesverbalit nga mbledhja e dt. 06.03.2015;**
- 3. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L-09 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;**
- 4. Të ndryshme.**

Kryetarja-Teuta Sahatqija pasi konstatoi se janë plotësuar kushtet për punë e hapi mbledhjen.

Fillimisht i uroj mirëseardhje anëtares së re të komisionit znj. Time Kadriaj dhe njëherit shprehi kënaqësinë se po rritet numri i grave në këtë Komision.

1. Miratimi i rendit të ditës;

Rendi i ditës u miratua.

2. Miratimi i Procesverbalit nga mbledhja e datës 6.03.2015.

Procesverbali u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L-09 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së.

Kryetarja lidhur me këtë projektligj tha se nga komisioni funksional kemi marr raportin i cili përmban 10 amendamente, në vazhdim lexoj opinionin ligjor lidhur me këtë projektligj, me të cilën është konstatuar se projektligji së bashku me amendamentet e komisionit funksional nuk është në kundërshtim me legjislacionin e Bashkimit Evropian, përkatësisht me Acquis të BE-së. Lidhur me këtë hapi debatin

Arben Gashi mendon se nuk do të ishte mirë që të shqyrtohet ky projektligj para Komisionit për Legjislacion për shkak të procedurës e cila është përdorur, sepse është në kundërshtim me rregulloren e punës së Kuvendit dhe në kundërshtim me praktikën më të mira Evropiane, sepse shumica e amendamenteve janë bërë në ligjin bazik, andaj tha se do të ishte mirë me prit vendimin e Komisionit për legjislacion sepse mund të ndodhë që ta japin mendimin negativ lidhur me këto amendamente.

Vjosa Osmani tha se gjysma e amendamenteve që janë sjell nga komisioni funksional për zhvillim ekonomik janë në ligjin bazik, sa i përket amendamentit 9 në të cilën thuhet se përbërja e bordeve të drejtorëve të ndërmarrjeve publike duhet të jenë në harmoni me ligjin për barazi gjinore, kjo në vetvete nuk nënkupton se do të përdoret kuota në borde sepse Ligji për barazi gjinore nuk e obligon kuotën për ndërmarrje publike por vetëm për institucionet e tjera, me këtë gjuhë nuk arrihet asgjë por duhet me qenë më specifike. Problemi është se nëse komisioni e ka pas ndërmend me i hy ligjit bazik prej fillimit se është nismë e re dhe është dashtë me u njoftua të gjithë deputetët që kanë të drejtë me paraqit amendamente në nënë tjera të ligjit bazik, sepse nuk mundën vetëm 9 anëtarët e komisionit për zhvillim ekonomik me pas të drejtë me i hy në tersi ligjit bazik, kurse të gjithë deputetët e tjerë të kuvendit mos me pas këtë të drejtë, andaj e konsideron si shkelje të drejtave dhe detyrave të deputetit që parashiher në Rregulloren e punës. Në vazhdim tha se si komision duhet ta marrim një vendim ose ta pranojmë kështu si është, apo ti kthejmë rekomandim komisionit për zhvillim ekonomik që ne nuk mund të i shqyrtojmë konformë rregullores së punës ndryshimet në Ligjin bazik, ose të i hyjmë prej fillimit kësaj procedure dhe ata të propozojnë nismë të re legjislative dhe të gjithë deputetët të kenë të drejtë që asaj nisme ti japin vërejtjet apo amendamentet e veta.

Kryetarja: Sa i përket fushëveprimtarisë së Komisionit tonë, ne e kemi për detyrë ti analizojmë Projektligjet dhe amendamentet e komisioneve funksionale se a janë në përputhshmëri me legjislacionin të BE-së, andaj ne në rekomandimin tonë mund të themi se sa i përket substancës së projektligjit është në përputhshmëri me legjislacionin e BE-së, po ashtu edhe ato amendamente ku nuk preket ligji bazik, kurse, janë në kundërshtim me rregulloren e punës së Kuvendit ato amendamente të cilat janë bërë në Ligjin bazik.

Vjosa Osmani tha se një prej parimeve të Acquis communautaire është parimi i hierarkisë ligjore dhe është parim bazik mbi të cilën është ndërtua BE, kjo nënkupton që çdo akt juridik që ne e miratojmë duhet të jenë në përputhje me aktet më të larta, në këtë rast me Kushtetutën dhe kushtetuta ne na obligon që ligjet të miratojmë sipas procedurës së përcaktuar në rregulloren e punës, kurse në këtë rast parimi i hierarkisë ligjore nuk është respektuar, pra këtu kemi problem edhe me aspektin e përputhshmërisë me acquis communautaire dhe në aspektin e përputhshmërisë me procedurat tona.

Kryetarja pas diskutimeve dhe propozimeve të bëra me shumicë votash nxori këtë;

Rekomandim

1. Projektligji nr. 05-L-09 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, nuk është në kundërshtim me parimet e përgjithshme të legjislacionit të Bashkimit Evropian.

2. Amendamentet e propozuara, nga numri një (1) deri në gjashtë (6) nuk janë në kundërshtim me legjislacionin e Bashkimit Evropian, ndërsa amendamentet nr. 7, 8, 9 ,10 të cilat ndryshojnë Ligjin bazik, janë në kundërshtim me parimin e hierarkisë së akteve ligjore si parim bazë i Acquis së BE-së.

4. Të ndryshme

Pasi në këtë pikë nuk kishte çështje për të ngritur **Kryetarja** e mbylli mbledhjen.

Mbledhja përfundoi në orën 11:25.

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetare e Komisionit

Znj.Teuta Sahatqia
